



100 Vjet Pavarësi

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË



### KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 2468 Prot.



### KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 285 Prot

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### LIDHUR NDËRMJET

*Palëve:*

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënavë Personale, (*referuar si KMDP*), përfaqësuar nga zonja Flora ÇABEJ (POGAÇE);

Dhe

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, (*referuar si KMD*), përfaqësuar nga zonja Irma BARAKU;

Të cilët janë autoritetet që do të zbatojnë kërkesat e kësaj marrëveshje:

*Të vetëdijshme* për rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për forcimin e shtetit të së drejtës, për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, dhe në veçanti për mbrojtjen e të dhënavë personale, mbrojtjen nga diskriminimi dhe respektimin e parimit të barazisë ndërmjet individëve.

*Me qëllimin* për të kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në procesin e zbatimit të legjisacionit respektiv të dy institucioneve për arritjen e objektivave të përbashkëta duke ruajtur identitetin e tyre të ndryshëm, qëllimet dhe objektivat e tyre;

*Me dëshirën e mirë* për të kontribuar që ky bashkëpuni i ndërsjellët të shtojë urat e bashkëpunimit të dy institucioneve që nënshkruajnë këtë marrëveshje.

*Palët kanë rënë dakord për sa më poshtë:*

**Neni 1**  
**Qëllimi**

**1.1** Palët do të bashkëpunojnë me qëllim zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe Ligjit Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellët të dy palëve.

**1.2** Për arritjen e këtij qëllimi bashkëpunimi i palëve do të realizohet mbi baza të njëjtë dhe mbi parimin e reciprocitetit.

**Neni 2**  
**Angazhimet e palëve**

**2.1** Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi angazhohen që të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në respekt dhe zbatim të kërkesave ligjore respektive të cituara më sipër, në këto drejtime:

- Do të bashkëpunojnë në kuadrin e grupit të punës për hartimin e akteve administrative dhe ligjore dhe për zbatimin e tyre .
- Do të marrin pjesë në grupet e punës për hartimin e udhëzimeve apo rekomandimeve të posaçme të palëve, për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe mbrojtjes nga diskriminimi.
- Do të kërkojnë informacione për shkëmbim eksperience të veprimtarisë së palës tjeter.
- Do të bashkëpunojnë për sa i përket organizimit të seminareve, trajnimeve për kategori të veçanta subjektesh.
- Do të marrin pjesë në aktivitete trajnimi të zhvilluara nga pala tjeter.
- Do të bashkëpunojnë për rritjen e ndërgjegjësimit tek qytetarët, organizimin e fushatave të përbashkëta sensibilizuese, për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.
- Do të bashkëpunojnë për përpunimin e të dhënave sensitive që kanë të bëjnë me origjinën racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale të individëve me qëllim parandalimin e diskriminimit;
- Do të bashkëpunojnë në zhvillimin e tryezave të përbashkëta të diskutimit, edhe me aktorët përgjegjës për forcimin e zbatimit të legjislacionit;
- Do të bashkëpunojnë në adresimin e rasteve që janë në objekt të punës së institucioneve respektive dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për zgjidhjen me efektivitet të tyre;

2.2 Palët do të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera për të cilat mund të bihet dakort në të ardhmen.

Neni 3  
**Koordinimi ndërmjet palëve**

3.1 Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.

3.2 Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me palën tjetër.

Neni 4  
**Amendimet**

Palët do të bëjnë amendime në këtë marrëveshje, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të tyre, paraqitur me shkrim.

Neni 5  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar. Megjithatë, ajo mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër 30 ditë para.

Marrëveshja e sipërme do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga titullarët e palëve.

Hartuar në Tiranë, më datë 11.07.2017, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënavë Personale dhe në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

**PËR KOMISIONERIN PËR  
MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE**

**KOMISIONERI**

**Flora ÇABEJ (POGAÇE)**



**PËR KOMISIONERIN PËR  
MBROJTJEN NGA  
DISKRIMINIMI**

**KOMISIONERI**

**Irma BARAKU**

